



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ekrem Kastrati, Kryetar i Komunës së Malishevës Enver Hoti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Nga:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Datë: 13.01.2026
Zyrtarët përgjegjës:	Erbllin Hëtemi, Drejtor i Departamentit Ligjor VI-020-7 Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit Donjeta Cakolli, Zyrtare e lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës
Lënda:	Shkresë përcjellëse
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Bazuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, (shtojca II - Aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të Kuvendit të Komunës së Malishevës, vlerëson se:

- Vendimi Nr.02/257, i datës 31.12.2025, për formimin e komisionit për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës në Malishevë, nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

HYRESE - ULAZNA - INCOMING		
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarsitvo Lokalne Samouprave / Administracije Ministry of Local Government Administration		
Data, Datum, Date,	08.01.2025	
Njësia organizative	Nr. i Lendës	Vlera
-VI-	020-7	



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

PRANUAR NE
ACCEPTED ON 31/12/2025
PRIME JENO
07/252

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/
Datë: 31.12.2025

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2, shkronja (d), nenit 41 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008"), nenit 2 paragrafi 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.2009/01 të MAPL, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 datë: 14.09.2023, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e mbledhjes së -I- të (jashtëzakonshme) të mbajtur me datë: 31.12.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës në Malishevë

1. Me këtë vendim formohet Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit, për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës.
2. Mbështetur në pikën 1 të këtij vendimi Komisioni është në këtë përbërje:
 1. Amrush Helshani nga Nisma-Socialdemokrate-Kryesues i Komisionit,
 2. Imran Xhyliqi nga Partia Demokratike e Kosovës-anëtar
 3. Xheneta Morina nga Lidhja Demokratike e Kosovës- anëtare
3. Komisioni i formuar sipas pikës 1 të këtij vendimi është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të votimit, numërimin dhe komunikimit të votave para anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi përmes Kryetarit të Komunës.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/ 2008"), dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:

1. Anëtarëve të Komisionit,
2. MAPL-së,
3. Arkivit të Komunës.

Anëtari më i vjetëri i Kuvendit

Enver Hota

